



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2021:253435

Datë: 29.03.2024

Numri i dokumentit: 05525964

KF.nr.572/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS – Dhoma e shkallës së parë, Departamenti Fiskal, me gjyqtaren Vera Gashi Bala , dhe zyrtaren ligjore Arta Hyseni në konfliktin tregtar administrativ të paditësit N.T.SH. “Bekimi Commerce” SH.P.K. me numër unik identifikues 810444266 dhe seli në Prishtinë, rr. “Vëllezërit Fazliu”, nr.267, përfaqësuar nga Shoqëria e Avokatëve “SCLR Partners”, Sh.P.K, me seli në Soliteri Avalla P+12, kundër të paditurës Dogana e Kosovës, duke vendosur lidhur me padinë e paditësit për anulimin e vendimi, baza juridike vlerësim doganor, në seancën e shqyrtimit gjyqësor kryesor-publik të mbajtur me datë 22.03.2024 në prani të përfaqësueses të palës paditëse G.B. dhe përfaqësueses së palës së paditur Krenare Shala, mori këtë:

A K T G J Y K I M

- I. APROVOHET si e bazuar kërkesëpadia e paditësit N.T.SH. “Bekimi Commerce” SH.P.K, me seli në Prishtinë.
- II. ANULOHET Aktvendimi me nr. 01.3.2.2/15150 i datës 06.10.2021, i Doganës së Kosovës me seli në Prishtinë.
- III. OBLIGOHET e paditura Dogana e Kosovës me seli në Prishtinë, që paditësit N.T.SH. “Bekimi Commerce” SH.P.K me seli në Prishtinë, t’ia kthej shumën prej 8,677.62 € (tetë mijë e gjashtëqind e shtatëdhjetë e shtatë euro e gjashtëdhjetë e dy cent), të paguar më tepër, në emër të detyrimeve doganore, për shkak të rivlerësimit të mallit të zhdoganuar përmes Deklaratave Unike Doganore me nr. R-51793 i datës 07.07.07 dhe R-55425 i datës 19.07.2021, të proceduar në Zyrën e Brendshme Doganore Prishtinë, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi.
- IV. Secila palë i bart shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësi NTSH Bekimi Commerce Sh.P.K nga Prishtina, përmes përfaqësuesit të autorizuar, me padinë e paraqitur në Gjykatë, me datë 11.11.2021, ka iniciuar konfliktin administrativ kundër të paditurës Dogana e Kosovës në Prishtinë, me të cilën i ka propozuar gjykatës aprovimin e kërkesëpadisë si të bazuar, të anulohet si i pabazuar aktvendimi i Doganës së Kosovës nr. 01.3.2.2/15150 datës 06.10.2021, dhe të obligohet Dogana e Kosovës që mjetet monetare më shumë të paguara në emër të detyrimeve doganore t'i kthehen paditësit në xhirollogarinë bankare. Gjatë seancës së shqyrtimit kryesor publik përfaqësuesja e paditësi ka deklaruar se mbesin në tërësi pranë kërkesëpadisë dhe pranë të gjitha pretendimeve të thëna në padi. Më tej ka shtuar se shkalla e dytë e kësaj gjykate e ka kthyer këtë çështje në rishqyrtim dhe rivendosje pasi është konstatuar se aktgjykimi i shkallës së parë Anr.2685/21 i dt 08.02.2022 ka të meta të cilat janë cekur edhe në aktgjykim gjithnjë sipas këtij aktgjykimi konstatimi i shkallës së parë se paditësi nuk ka paraqitur dokumentacioni të mjaftueshëm dhe të besueshëm nuk është i qëndrueshëm. Ka shtuar se meqenëse kjo çështje është kthyer në shkallë të parë për rigjykim , gjykatës i ka propozuar që nxjerrja e provës të bëhet me ekspertizës financiare e cila detyre kryesore do të kishte përcaktimin e vlerës së kontestit përkatësisht vlerës së paguar nga paditësi gjatë zhdoganimit dhe duke bërë edhe harmonizimin e dokumentacionit, pro faturave dhe faturave, transaksionit bankar si dhe çdo gjë tjetër e cila do të ishte e nevojshme me këtë konflikt administrativ. Ndërsa në fjalën përfundimtare ka theksuar se mbesin në tërësi pranë kërkesë padisë dhe të gjitha deklarimeve në seancën e sotme dhe në seancat e kaluar dhe i propozoj gjykatë që veproj sipas kërkesë padisë dhe të marrë një aktgjykim me të cilin aprovohet kërkesëpadia e paditësit, të anulohet aktvendimi i të paditurës dhe të obligohet e paditura që ti'a ktheje mjetet monetare në shumën prej si të nxjerrë nga organi i të paditurës respektivisht 8,677.62 euro dhe kamatën ligjore prej 8% në vit të llogaritur nga dita e ushtrimit të padisë deri në pagesën përfundimtare.

E paditura në përgjigje në padi të datës 25.11.2021 e ka kundërshtuar në tërësi kërkesëpadinë e paditësit si të pabazuar. Më tej ka shtuar se vendimi i atakuar është marr konform dispozitave në fuqi dhe pretendimet e palës paditëse për shkelje ligjore nuk qëndrojnë, për arsye se pala paditëse pretendimet e veta nuk i ka vërtetuar as edhe me një provë të vetme duke i propozua gjykatës që padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit ta refuzoi si të pa bazuar. Gjatës seancës së shqyrtimit gjyqësor, ka deklaruar se e paditura ka bërë analizë të çmimeve duke konkluduar se çmimi i prezantuar nga paditësja nuk mund të pranohet si real pasi që dokumentacioni i mallit është vlerësuar si provë e pamjaftueshme, sepse në rastin konkret

dërguesi i mallit janë Emiratet e Bashkuara Arabe dhe fatura e bashkangjitur në raport me profatura ka mospërputhje në kuptim të vlerës dhe sasisë. Po ashtu edhe kontrata në mes të palëve kontraktuese nuk përmban të dhëna lidhur me ndryshime që mund ti ketë malli lëndor në kuptim të humbjes së peshës e cila ndikon në vlerën e mallit, prandaj edhe është caktuar bazë e re doganore, çmim i cili është marrë nga bursa ndërkombëtare Reuters në kohën e blerjes së mallit. Ndërsa propozimin e përfaqësueses së paditëses për nxjerrën e provës me ekspertizë financiare e ka kundërshtuar me arsyetimin se vlera e kontestit sipas të dhënave të doganës është 8,677.62 euro.

Gjykata themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative me aktgjykimin A.NR.2695/21 të datë 08.02.2022, kishte refuzuar kërkesëpadinë e paditësit duke lënë në fuqi aktvendimin kontestues të Doganës së Kosovës.

Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhomat e Shkallës së Dytë, duke vendosur sipas ankesës së paditëses, me aktvendimin K.DH.SH.II. 1205/22 të datës 31.08.2023, ka anuluar aktgjykimin A.nr.2695/21 dhe çështjen e ka kthyer në rigjykim dhe rivendosje dhomave të shkallës së parë të kësaj gjykate.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, Gjykata në procedurën e provave të shqyrtimit gjyqësor-publik të datës 22.03.2024, ka administruar provat si në vijim: Aktvendimi 01.3.2.2/15150 i datës 06.10.2021, Ankesë e paditësit te Sektori për rishqyrtim të vendimeve, DUD R-51793, Pagesë ndërkombëtare e datës 20.07.2021, Proces mbi përcaktimin e mallrave e datës 04.01.2018, Faturë 309-2017 e datës 28.12.2017, CMR nr. 04052, T1 e datës 28.12.2017, Pagesë bankare 21.12.2017, DUD 888 i datës 10.01.2018, Faturë 004-2018 e datës 08.01.2018, CMR e datës 08.01.2018, Dokument i datës 25.10.2010, Pagesa e datës 10.01.2018, Proces mbi përcaktim e vlerës së malli DUD 75382, ASYCUDA, Vendimi nr.07.3/622, 670, 671, 840, 841, 842, 843, 844/2014, Vendimi nr. 05.2.1/1141, 1226/2021, Vendimi 04/2012.

Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit kontestues, thënieve në padi, përgjigjes në padi, shkresave të lëndës në këtë konflikt administrativ, vlerësoi secilën provë veç e veç dhe të gjithave se bashku, duke marr për bazë edhe vërejtjet e dhomave të shkallës së dytë të kësaj Gjykate, mbështetur edhe në dispozitat nga neni 8, i Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK-së), dhe arriti në përfundimin se në këtë kontest tregtar administrativ, duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, për këto arsye:

Nga arsyetimi i vendimit kontestues gjykata konstaton se e paditura ka refuzuar ankesën e paditësit për arsye se vlera e mallit e deklaruar për zhdoganim nuk është çmim real i paguar për mallin me qëllim të importit në vendin tonë, për arsye se është deklaruar vlerë më e vogël se sa vlera e paguar apo që ka për tu paguar për mallin e shitur për eksport përkatësisht për import në vendin tonë në vështrim të nenit 33 të Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës, andaj Dogana ka vendosur që vlera doganore të caktohet në bazë të metodës së 6 (gjashtë) të vlerësimit në vështrim të nenit 35, të Kodit Doganor dhe të Akcizave, respektivisht në bazë të të dhënave me të cilat disponon Dogana e Kosovës, çmimet e nxjerra nga bursa ndërkombëtare Reuters në kohën e blerjes së mallit. Dokumentacioni përcjellës i mallit është konsideruar i pamjaftueshëm pasi që mungon deklarata eksportuese dhe se fatura e bashkangjitur në raport me profaturën ka mospërputhje në kuptim të vlerës dhe sasisë përderisa kontrata e bashkangjitur nuk përmban të dhëna lidhur me ndryshimet që mund ti ketë malli lëndor në kuptim të humbjes së peshës e cila ndikon në vlerën e mallit.

Gjykata propozimin e përfaqësueses së paditësit për nxjerrjen e provës me ekspertizë financiare me qëllim të përcaktimit të vlerës së kontestit, e refuzoi, kjo për faktin se nga shkresat e lëndës, vlera e kontestit rezultoi të jetë e pakontestueshme e gjithashtu e paditura nuk e kontestoi të njëjtën.

Me Dispozitën ligjore të nenit 33 par 1 të KDAK-së është përcaktuar se “*Vlera doganore e mallrave të importuara është vlera e transaksionit, që paraqet çmimin vërtetë të paguar ose të pagueshëm për mallrat e shitura për eksport në Kosovë, i përshtatur, sipas nevojës, në përputhje me nenet 36 dhe 37*”.

Tutje, në paragrafin 3 të nenit 33 të KDAK-së përcaktohet se “*Çmimi vërtetë i paguar apo i pagueshëm është pagesa e plotë e bërë ose që duhet bërë nga blerësi për shitësin ose në dobi të këtij të fundit për mallin e importuar dhe që përfshin të gjitha pagesat e bëra ose që duhen bërë, si kusht i shitjes së mallrave të importuara nga blerësi për shitësit, ose nga blerësi për një palë të tretë për ta përmbushë obligimin ndaj shitësit. Pagesa mund të mos bëhet patjetër në formën e transferit të parave. Pagesa mund të bëhet me anë të letrave të kredisë ose ndonjë mjete tjetër të dakorduar të pagesës dhe mund të bëhet drejtpërdrejt ose në mënyrë të tërthortë*”. Ndërsa, se cilat dokumente duhet ti bashkëngjiten deklaratës doganore për vendosje në qarkullim të lirë të mallit, është e rregulluar me nenin 123 par. 1 pika (a) të UA nr.11/2009 për Implementimin e Kodit Doganor dhe Akcizave nr.03/L-109, ku decidivisht përcaktohet se “*a) fatura në bazë të së cilës deklarohet vlera doganore e mallrave, siç kërkohet sipas nenit 91 të këtij akti*”.

Nga provat e administruara në këtë konflikt administrativ gjykatës i rezultoi një gjendje tjetër faktike nga gjendja të cilën e ka konstatuar organi i paditur gjatë procedimit administrativ. Gjykata konstaton se dokumentacioni për mallin lëndor i paraqitur në procedurën administrative dhe në këtë konflikt administrativ është i mjaftueshëm për të konstatuar se vërtet paditësi ka paguar vlerën reale të mallit lëndor.

Deri te ky konstatim gjykata erdhi pas analizimit të transfereve bankare, pro faturave të bashkangjitura si dhe DUD-ve, e sipas të cilave gjykata konstaton se në faturën e datës 07.05.2021 evidentohet shuma prej 49515 \$ për DUD-in R-51793/07.07.2021 e cila është më e ulët sesa ajo që i referohet profaturës dhe transaksionit në shumë 49800 \$, ndërsa nga fatura e prezantuar e datës 07.05.2021 evidentohet shuma prej 48961\$ për DUD-in R- 55425/19.07.2021, e cila është më e ulët sesa ajo që i referohet pro faturës dhe transaksionit në shume prej 49800\$.

Pas analizimit të pro faturave nr. 86 dhe 87, gjykata konstaton se çmimi në faturë paraqet çmim më të ulët sesa çmimi real i paguar i cili është paguar sipas pro faturës, e që rezulton që çmimi të jetë paguar me shume se sa vlera e deklaruar.

Nga kjo gjendje faktike, Gjykata vlerëson se e paditura pa bazë ligjore dhe prova materiale të besueshme e ka rivlerësuar mallin lëndor të deklaruar për zhdoganim nga paditësi, përmes DUD-ave, R-51793/07.07.07 dhe R 55425/19.07.2021, të proceduar në Zyrën e Brendshme Doganore Prishtinë, dhe në këtë mënyrë të njëjtin e ka obliguar pa të drejtë me pagesën e detyrimeve shtesë importuese doganore në shumë prej 8,677.62 €, mbi vlerën e deklaruar të mallit të importuar.

Gjykata nga shkresat e lëndës vlerëson se me asnjë provë nuk është provuar konstatimi i të paditurës i dhënë në vendimin e kontestuar, sipas të cilit vlera e deklaruar e mallit lëndor nga paditësi, nuk është vlera reale e paguar e mallit me qëllim importi në vendin tonë në vështrim të nenit 33 të KDAK-së.

Gjykata konstaton se në rastin konkret paditësi ka vërtetuar se pagesa nga profatura nr.86 e deklaruar me DUD-in 51793/07.07/2021 është realizuar përmes transferit ndërkombëtar me numër të referencës FT211871119R me datë 06.07.2021 dhe se profatura nr.87 në vlerë prej 49800 USD, e deklaruar me DUD-in 55425/19/07/2021 është paguar përmes transferit ndërkombëtar me numër të referencës FT21179BMG8K, të datës 28.06.2021.

Rrjedhimisht, Gjykata vlerëson se të gjitha dokumente e prezantuar të paditurës lidhur me deklaratat unike doganore kontestuese, rezultojnë të jenë të harmonizuara në tërësi sa i përket vlerës së mallit të importuar nga paditësi konform nenit 33 par.1 të KDAK-së.

Prandaj nga gjendja faktike e vërtetuar më lartë, Gjykata pretendimet e paditësit lidhur me deklaratat unike doganore kontestuese, i vlerësoi si tërësisht të bazuar dhe se dokumentacioni i prezantuar është i pa kontestueshëm nga pikëpamja ligjore për zhdoganimin e mallit lëndor, konform nenit 33 par.1 të Kodit Doganor dhe të Akcizave.

Gjykata në pajtim me dispozitat ligjore nga neni 46 paragrafi 4 dhe 5 të Ligjit nr.03/L-202 për Konfliktet Administrative, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi ashtu që aprovoi kërkesëpadinë e paditësit, e anuloi vendimin e kontestuar të të paditurës dhe e detyroj të paditurën që paditësit t'i kthej shumën prej 8,677.62 €, të paguar më tepër për shkak të rivlerësimit jo të drejtë të mallit, në emër të detyrimeve importuese, për mallin e zhdoganuar përmes dūdave kontestues të proceduar në Zyrën e Brendshme Doganore Prishtinë.

Gjykata i ka vlerësuar deklaratimet dhe provat tjera materiale të cilat gjenden në shkresat e lëndës, por erdhi në përfundim se të njëjtat janë pa ndikim në vendosjen ndryshe të kësaj çështje juridike administrative.

Vendimin që secila palë ti bartë shpenzimet e procedurës, gjykata e ka mbështetur në dispozitat e nenit 64 të LKA-së nr.03/L-202 për Konfliktet Administrative.

Nga të lartcekurat, gjykata konform nenit 46 par. 2, 4 dhe 5 të LKA-së, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti Fiskal
KF.nr.572/23, datë 22.03.2024

Gjyqtarja
Vera Gashi Bala

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi, është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, dhomave të shkallës së dytë, përmes dhomave të shkallës së parë të kësaj Gjykate.